



Zambak uji / Water Lilies

## Sytë në ajër, tokë, det

Të pëlqen të kundrosh natyrën dhe peizazhin, të njohësh botën e egër dhe të përjetosh aventura të reja? Atëherë ndodhesh në vendin e duhur! Me një bukuri magjepsëse, ku relievi i thyer të ofron malin dhe detin, me një botë të egër të larmishme me 5,500 lloje bimësh dhe 15,600 lloje kafshësh, AOS - Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë do ju udhëheqë në një rrugëtim të paharrueshëm në thesaret e biodiversitetit Shqiptar!

**“Menduam të kombinonim në një paketë të vetme natyrën dhe botën e egër për të krijuar të parin produkt**

## Thrills of exploring Albania’s wildlife tourism eyes in AIR, LAND, WATER

Passionate about nature and landscaping, interesting in wildlife and ready for new adventures? You have reached your destination! With a breath-taking beauty, where the rough landscape offers the mountain and the sea, with a diverse wildlife of more than 5,500 plant and 15,000 fauna species, AOS, Albanian Ornithologist Society, will guide you in a treasured journey through Albania’s rich biodiversity!

**“We thought to combine into a single package nature and wildlife aiming at creating the first tourism product of**

**turistik të vrojtimit të zogjve dhe kundrimit të natyrës në rajonin e Shkodrës**” - shpjegon ornitologu Taulant Bino, drejtues i AOS. Bino e prezantoi këtë produkt në konkursin Risi Turistike që u organizua në Shkodër në Maj 2015 me të cilin fitoi çmimin e parë. Kjo ide u mbështet nga Projekti RisiAlbania, duke e shndëruar Shkodrën, në një kohë të shkurtër, në një destinacion turistik tërheqës.

U zhvilluan 4 itinerare turistike të vrojtimit të zogjve, luleve dhe fluturave për rajonin e Shkodrës: (1) Buna dhe Velipoja, (2) Liqeni i Shkodrës, (3) Vermoshi dhe (4) Thethi. **“Këto itinerare dhe ture të reja afrojnë jo vetëm njerëzit me natyrën por edhe ndihmojnë në pasurimin e regjistrit të florës dhe faunës së zones dhe mbrojtjen e saj”** - thotë me krenari Taulanti.

Prugëtimi nis me zgjimin herët në mëngjes dhe pas mëngjesit të shijshëm me prodhime vendase, turistët e pajisur me teleskopë dhe dylibi udhëtojnë për rreth 4 orë duke

**bird watching and enjoying nature in Shkodra region**”, explains ornithologist Taulant Bino, Head of AOS. Bino presented this innovative idea at the Risi Turistike Competition Award organized for Shkodra region in May 2015 and it won the 1st Prize.

This new idea, supported by RisiAlbania, made Shkodra a very attractive tourism destination in a short period of time.

Four wildlife tourism itineraries for birdwatching, flowers and butterflies in Shkodra region were created: (1) Buna and Velipoja (2) Shkodra Lake (3) Vermosh and (4) Theth). **“New itineraries and tours contribute to bringing people closer to nature and increase data collection efforts towards the inventory of Birds Breeding in Albania ”**, says Taulant proudly.



kundruar dhe shijuar natyrën që ofron zona e Shkodrës, bukuritë e të cilës të lënë pa frymë.

Përgjatë vitit të parë u organizuan 6 ture vëzhgimi në rajonin e Shkodrës të cilët tërhoqën mbi 100 turistë vendas dhe të huaj, që provuan edhe eksperiencat e reja si peshkimi, shëtitjet me biçikleta dhe shijuan gatimet dhe pijet tradicionale të zonës. **“Aktiviteti ekonomik i zonës së Shkodrës, kryesisht peshkimi, bujqësia, pylltaria, turizmi dhe rekreacioni mbështeten në burimet natyrore të zonës, të cilat kanë një potencial të jashtëzakonshëm për tu zhvilluar”** - thotë Bino.

Brenda një viti u trajnuan 15 udhërrëfyes të vëzhgimit të zogjve dhe botës së egër të cilët u çertifikuan për ofrimin e tureve në parqet kombëtare, rezervatet natyrore të menaxhuara, peizazheve të mbrojtura dhe zonat RAMSAR të vendit.

Me mbështetjen e projektit RisiAlbania, AOS zhvilloi për herë të parë produktin **“Turizmi i Kundrimit të Natyrës”** për të apasionuarit pas natyrës në rajonin e Shkodrës i cili shumë shpejt u zhvendos dhe po zhvillohet në 12 rajonet dhe zonat e mbrojtura të vendit. Produkte të tilla zhvillojnë turizmin e natyrës në Shqipëri, i cili zotëron një potencial të jashtëzakonshëm.

The journey starts very early in the morning and after a healthy breakfast with local products, travellers equipped with telescopes and binoculars walk around for 4 hours and lookout and enjoy the breath-taking nature Shkodra region offers.

AOS organised six birdwatching tours in Shkodra during its first year of operation, attracting more than 100 local and foreign tourists. They also experienced other areas of interest including cycling, fishing and tasted local food and drinks. **“The economic activities in Shkodra, in particular agriculture, fishery, forestry, tourism and recreation rely on region’s natural resources which have great potentials for development”**, - says Bino.

Over the course of one year, 15 Birdwatching & Wildlife tourist guides were trained and awarded first certificates for offering tours throughout the country’s national parks, managed nature reserves, protected landscapes and RAMSAR areas.

With the support of RisiAlbania, AOS developed for the first time

### **“Wildlife Tourism”**

product for nature aficionados

in the area of

Shkodra, which very

soon was replicated in 12

protected areas of the country.

Such leading-edge ideas will serve as frontrunners in the development of Albania’s huge potential of wildlife tourism.

